

5831 dt 05. 10. 2020

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a  
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C  
OPERATOR SISTEMA PRENOŠA I TRŽIŠTA KOSTT d.d

Nr. 1595 Dt. 05/10/2020  
PRISHTINË-A

**Operatori i Sistemit të Transmetimit  
(OST)**

dhe

**Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut  
[KOSTT]**

**MARRËVESHJE E AKSIONARËVE PËR KRIJIMIN E BURSËS  
SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**



Kjo MARRËVESHJE E AKSIONARËVE ("Marrëveshja") lidhet *ndërmjet*:

**Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.**, një shoqëri që është themeluar dhe operon në bazë të ligjeve shqiptare, me Numër Regjistrimi Nr. K42101801N me adresë të regjistruar në: Autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Yrshek-Kashar, Tirana, Shqipëri, përfaqësuar sipas ligjit nga z. Skerdi Drenova (Administratori), (**OST**);

dhe

**Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut sh.a. – KOSTT sh.a.** një shoqëri që është themeluar dhe operon sipas ligjeve të Kosovës, me numër regjistrimi nr. 70325350, dhe numër unik identifikues 811284512, me adresën të regjistruar në: Rr. Isa Boletini nr. 39, 10000 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar sipas ligjit nga z. Ilir M. Shala, (Kryeshef Ekzekutiv), (**KOSTT**)

Të cilët në këtë Marrëveshjeje këtej e tutje do të quhen së bashku si "**Palët**" ose "**Aksionarët**" dhe individualisht si "**Pala**".

### **PËRSHKRIM:**

(A) Në 27 Prill 2016, me qëllim përbushjen e objektivave të paketës së tretë legjislativë në fushën e energjisë elektrike të BE për themelin e Tregut të Brendshëm Evropian të Energjisë Elektrike ("IEM") dhe bazuar në vendimet e arritura në Samitin e Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Vjenë më 27 Gusht 2015, Shqipëria dhe Kosova u angazhuan të krijojnë operatorët (bursa) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (DAM) dhe brenda ditës (IDM) në një treg rajonal.

Në Qershor 2018 OST, KOSTT, ERE dhe ZrrE, nënshkruan Memorandumin i Mirëkuptimit për bashkinin e tregut të energjisë elektrike për ditën në avancë

(B) Në përfundim të Procedurave të Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut, të zhvilluara nga Komisioni i Posacëm, në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", VKM nr. 322 datë 15.05.2019 dhe VKM nr. 609 datë 11.09.2019; OST dhe KOSTT nw zbatim tw parashikimeve tw VKM nr. 609 datë 11.09.2019, Njoftimit të fituesit nga Komisioni i Posacëm dhe Njoftimit nga MIE për fillimin e negociatave, kanë rënë dakord për të hyrë në këtë marrëveshje.

(C) Palët kanë vendosur të hyjnë në këtë Marrëveshje për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas cilave do të bashkëpunojnë, duke vlerësuar së është në interesin më të mirë të tyre dhe Shoqërisë, të bien dakord dhe të hartojnë dispozita për çështje të caktuara në lidhje me marrëdhënien e tyre si aksionarë brenda shoqërisë.

Prandaj, Palët kanë rënë dakord si më poshtë:



## 1. Interpretimi dhe Përkufizimet

### 1.1 Në këtë Marrëveshje:

- (a) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas, dhe secila gjini përfshin gjinitë e tjera;
- (b) referenca "me shkrim" do të jetë vetëm për letrat dhe faksimilet;
- (c) titujt janë dhënë vetëm për lehtësi të leximit dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;
- (d) referenca ndaj një dispozite ligjore ose ligji përfshin një referencë ndaj asaj dispozitë ligjore ose ligji të ndryshuar, që i është zgjatur afati ose që zbatohet nga ose *nën* ndonjë statut ose ligj tjetër pas nënshkrimit;
- (e) asnje dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet kundër njërsës Palë vetëm duke u nisur nga fakti së kjo Palë ishte përgjegjëse për hartimin e një dispozite të tillë;

### 1.2 Përkufizime

- "**Marrëveshje**" nënkupton këtë Marrëveshje të Aksionarëve.
- "**Degë**" nënkupton një vend të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe ka të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ajo vepron në mënyrë të qëndrueshme, organizohet dhe administrohet më vete dhe ushtron veprimitari me palë të treta, në emër të shoqërisë.
- "**Ligj në fuqi ose Ligj i Shoqërisë**" nënkupton Ligjin Shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- "**Shoqëria**" nënkupton subjektin e të drejtës shqiptare (ALPEX), të regjistruar si një shoqëri aksionare, të themeluar në bazë të ligjeve shqiptare, përgjegjëse për krijimin, menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike (në vijim referuar edhe si "Tregu") nëpërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financial (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike, Rregullat e Tregut të energjisë elektrike dhe Modelin e Tregut të energjisë elektrike, në fuqi në Republikën e Shqipërisë
- "**Rast i mos përbushjes**" ka kuptimin e dhënë për këtë term në pikën 13.3 të kësaj Marrëveshje.
- "**Data e Hyrjes në fuqi**" nënkupton datën e parashikuar në këtë marrëveshje.



- “*Aksione*” nënkupton aksionet e shoqërisë në pronësi të çdo aksionari.
- “*Asamble e Përgjithshme*” ka kuptimin e dhënë në Statutin e shoqërisë dhe Ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
- “*Këshilli Mbikëqyrës*” ka kuptimin e dhënë në Statutin e shoqërisë dhe Ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregtaret Shoqëritë Tregtare”
- “*Statuti i Shoqërisë*” nënkupton dokumentin themelor të Shoqërisë.

## 2. Krijimi i Shoqërisë

- 2.1 Shoqëria do të krijohet nga aksionarët themelues në formën e Shoqërisë Aksionare në bazë të ligjit shqiptar, sa më shpejt të jetë e mundur, pas datës së lidhjes së Marrëveshjes.
- 2.2 Aksionarët pajtohen që emri i Shoqërisë të jetë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike”
- 2.3 Emri tregtar i Shoqërisë do të jetë ALPEX sh.a
- 2.4 Adresa e shoqërisë do të jetë: Autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Yrshek - Kashar, Tirana, Shqipëri.
- 2.5 Aksionarët bien dakord që Shoqëria në kuadër të zhvillimit të aktivitetit të saj të themelojë degë ose zyrë përfaqësimi në Kosovë. Gjithashtu, Shoqëria në kuadër të zhvillimit të aktivitetit të saj mund të themelojë degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri, dhe/ose në vende të tjera.

## 3. Statuti i Shoqërisë

- 3.1 Palët bien dakord që Statuti i Shoqërisë të reflektojë sa të jetë e mundur përbajtjen dhe marrëveshjen e arritur nga Palët këtu, përvèç nëse modifikohet në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi dhe në përputhje me ndryshimet e mëtejshme të kësaj Marrëveshjeje siç mund të bien dakord Palët, herë pas here.
- 3.2 Në rast të ndonjë paqartësie ose mospërputhjeje ndërmjet parashikimeve të kësaj Marrëveshjeje dhe Statutit, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë mes Palëve, për aq kohë sa kjo Marrëveshje mbetet në fuqi.
- 3.3 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, secila Palë sillet në mënyrë të tillë që të përbushë plotësisht detyrimet e kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitat e Statutit të Shoqërisë.



#### **4. Aksionet**

4.1 Shoqëria do të ketë **250,000** (dyqind e pesëdhjetë mijë) aksione me vlerë nominale prej **1.000,00** (një mijë) lekë secila. Çdo aksion ka vlerë të njëjtë.

##### **4.2 Kapitali**

- 4.2.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 250,000,000.00 (dyqind e pesëdhjetë milion) lekë.
- 4.2.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë do të zotërohet nga këto aksionarë:

###### **1) OST sh.a**

Kapitali monetar themeltar i nënshkruar:

**143,125,000** (njëqind e dyzetë e tre milion e njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë  
Numri i aksioneve:

**143,125** (njëqind e dyzetetremijë e njëqindenjëzetepesë) aksione  
Pjesëmarrja në kapitalin e përgjithshëm:  
**57.25%** (pesëdhjeteshtatë pikë njëzetepesë)

###### **2) KOSTT sh.a**

Kapitali monetar themeltar i nënshkruar:

**106,875,000** (njëqindegashtë milion e tetëqindeshtatëdhjetë e pesëmijë) lekë  
Numri i aksioneve:  
**106,875** (njëqindegashtë mijë e tetëqindeshtatëdhjetëepesë) aksione  
Pjesëmarrja në kapitalin e përgjithshëm:  
**42.75%** (dyzetedy pikë shtatëdhjetëepesë)

- 4.2.3 Palët angazhohen të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për krijimin e shoqërisë dhe shlyerjen me kontributë në para të aksioneve të nënshkruara prej tyre sipas parashikimeve te kësaj marrëveshje.
- 4.2.4 Palët bien dakord se menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, para regjistrimit të shoqërisë, angazhohen se do të shlyejnë me kontributë në para 35 % të aksioneve të nënshkruara nga secila prej palëve që i korrespondon vlerave të mëposhtme:

###### **1) OST SH.a.**

Do të shlyejë 35% të Kapitalit monetar themeltar të nënshkruar, prej 50,093,750 (pesëdhjetë milion e nëntëdhjetë e tremijë e shtatëqindëpesëdhjetë)  
Lekë



## 2) KOSTT SH.a

Do të shlyejë 35% të Kapitalit monetar themeltar të nënshkruar, prej 37,406,250 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e gjashtë mijë e dyqindëdhjetë) Lekë

- 4.2.5 Palët marrin përsipër që brenda 12 muajve nga regjistrimi i shoqërisë, të shlyejnë me kontribute në para vlerën e mbetur të aksioneve të nënshkruara nga secila prej tyre. Palët autorizojnë shoqërinë që të përdorë, kapitalin e paguar për mbulimin e shpenzimeve operative dhe kapitale.

### 4.3 Rritja e kapitalit

- 4.3.1 Aksionarët do të kontribuojnë, në mënyrë proporcionale me vlerën e pjesëmarrjes së tyre, në rritjen e kapitalit të Shoqërisë sa herë të jetë e nevojshme të financohet aktiviteti i Shoqërisë ose sa herë bëhet e domosdoshme për të ndjekur objektivat e Shoqërisë.
- 4.3.2 Në rast të rritjes së kapitalit, Shoqëria do të emetojë aksione të reja dhe aksionarët aktualë do të kenë përparësi për nënshkrimin e aksioneve të reja në përpjesëtim me kontributin për këtë rritje të kapitalit sipas të drejtës së parablerjes.
- 4.3.3 Secili prej aksionarëve bie dakord dhe pranon së në rast së vendos të mos kontribuojë në rritjen e kapitalit dhe të mos pajtohet në aksione të reja, atëherë ai bie dakord dhe pranon çdo ndikim, ndryshim dhe/ose dobësim që rritja e kapitalit dhe nënshkrimi në aksione të reja i aksionarëve të tjera ose palëve të treta mund të kenë në pjesëmarrjen e tij/saj në shoqëri.
- 4.4 Vendimet për hyrjen e një aksionari të ri (pa u kufizuar vetëm nëpërmjet rritjes ose zvogëlimit te kapitalit dhe/ose shitjes se aksioneve) në shoqëri, duhet të merren me vendim unanim nga të gjithë aksionaret ekzistues.
- 4.5 Aksionet e Shoqërisë nuk mund të vendosen si garanci në favor të një pale pa miratimin unanim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast se një aksionar i ri hyn në shoqëri, ai/ajo do të kontribuojë në kapitalin aksionar të shoqërisë në përpjesëtim me aksionet e marra, dhe një kontribut i tillë do t'u shpërndahet proporcionalisht aksionarëve ekzistues, aksionet e të cilëve u zvogëluan.

## 5. Buxheti dhe Financimi

- 5.1 Shoqëria do të financohet me anë të kontributeve të kapitalit nga Aksionarët, derisa Shoqëria të krijojë fluks të mjaftueshëm pozitiv të parave. Aksionarët kanë si qëllim që, në momentin që Shoqëria do të krijojë fluks monetar pozitiv të mjaftueshëm, kërkesat për financim të Shoqërisë të përbushen nga fluksi i brendshëm i parave dhe nga huazimet tregtare nga Aksionarët ose palët e treta.



- 5.2 Financimi i bërë nga Aksionarët do të kryhet gjithmonë mbështetur në parimin e pavarësisë dhe barazisë së secilës palë dhe në përputhje me rregullat në fuqi dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore. Aksionarët angazhohen së nuk do të pengojnë ose të ndalojnë vendimet e nevojshëm për rritjen e financimeve që i duhen Shoqërisë, me kusht që një financim i tillë të bëhet me kritere dhe kushte të arsyeshme në përputhje me financimet alternative të mundshme për Shoqërinë.
- 5.3 Çdo Aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mënyrë proporcionale me kushte të barabarta në çdo financim që i jepet Shoqërisë. Aksionarët marrin përsipër të sigurojnë financimin e nevojshëm për Shoqërinë në mënyrë proporcionale bazuar në Buxhetin e aprovuar.
- 5.4 Nëse një Aksionar nuk arrin të sigurojë financimin brenda Buxhetit do të konsiderohet mos përbushje e Marrëveshjes së Aksionarëve.

## 6. Organet Drejtuese të Shoqërisë

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme
- 6.2 Mbledhja e aksionarëve të Shoqërisë përfaqësohet nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme dhe do t'i miratojë vendimet e saj me kuorumin e nevojshëm dhe me shumicë votash, siç parashikohet në Statut dhe në Legjislacionin në fuqi.
- 6.3 Në Asamblenë e Përgjithshme aksionarët përfaqësohen nga Kryeshefat Ekzekutiv apo Administratorët e Shoqërise themeluese.

## 7. Këshilli Mbikëqyrës

- 7.1 Palët bien dakord që Shoqëria të ketë një Këshill Mbikëqyrës të përbërë nga 5 anëtarë, të cilët do të caktohen dhe do t'i propozohen Asamblesë së Përgjithshme dhe do të miratohen nga Palët në Asamblenë e Përgjithshme, në përputhje me përcaktimet, propozimet dhe strukturën e përbërjes si më poshtë:

OST sh.a ka të drejtë të zgjedhë dhe propozojë 3 (tre) anëtarë;

KOSTT sh.a do të zgjedhë dhe propozojë 2 (dy) anëtarë;
- 7.2 Në rast së, për ndonjë arsy, një ose më shumë anëtarë duhet të zëvendësohen, anëtarët zëvendësues propozohen dhe caktohen nga aksionari që kishte propozuar anëtarin ose anëtarët që largohen dhe do të miratohen në përputhje me Statutin dhe me ligjin në fuqi.



## **8. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës**

- 8.1 Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme në rast së në mbledhje janë të pranishëm të paktën 4 anëtarë. Çdo anëtar ka vetëm një votë dhe në Këshill Mbikëqyrës nuk mbizotëron asnjë votë.
- 8.2 Këshilli Mbikëqyrës emëron dhe shkarkon Administratorin e Shoqërisë, në përputhje me Statutin. Propozimi për emërimin e Administratorit të parë, në mandatin e tij të parë, do të bëhet nga OST sh.a..

## **9. Drejtimi i Degëve**

- 9.1 Degët e Shoqërisë drejtohen nga Drejtuesi i Degës i cili propozohet nga Administratori i shoqërisë dhe emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, në përputhje me procedurën e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për përzgjedhjen e Administratorit te shoqërisë.

## **10. E Drejta e Informimit**

- 10.1 Palët bien dakord që e drejta e informimit e ushtruar ndaj Shoqërisë dhe aktiviteteve të Administratorit nuk ka kufizim, përvçe aq sa kufizohet sipas legjislacionit në fuqi dhe procedurave të parashikuara në Statut.

## **11. Përfaqësimet dhe Garancitë**

- 11.1 Secila Palë garanton që është themeluar dhe ushtron aktivitetin sipas legjislacionit në fuqi në juridiksonin ku vepron, si edhe është e regjistruar në të gjitha organet përgjegjëse të regjistrimit në atë juridikson dhe në çdo juridikson ku ushtron aktivitet biznesi, si edhe të dy Palët garantojnë së kanë fuqi të plotë që të ushtrojnë bizneset që ushtrojnë apo që do të ushtrojnë për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.
- 11.2 Secila Palë garanton si më poshtë:
  - a) ka kompetencat dhe autorizimet e nevojshme që të lidhë dhe të zbatojë këtë Marrëveshje dhe çdo marrëveshje lidhur me të;
  - b) e ka autorizuar dhe marrë përsipër zbatimin e kësaj Marrëveshje sipas tagrave të duhur dhe kjo Marrëveshje ngarkon detyrime të vlefshme dhe ligjërisht detyruese që janë të ekzekutueshme sipas kushteve të përcaktuara në të, duke iu nënshtuar legjislacionit përfalimentimin, paaftësinë pagese apo të ngjashme lidhur me të drejtat e kreditorëve në përgjithësi si dhe me parimet e përgjithshme të barazisë;
  - c) hartimi i kësaj Marrëveshjeje dhe respektimi i dispozitave të saj nuk rezulton



- në shkelje të Statutit të saj apo të ndonjë dispozite të legjislacionit në fuqi në lidhje me të;
- d) hartimi i kësaj Marrëveshjeje dhe respektimi i dispozitave të saj nuk është në konflikt, nuk rezulton në shkelje, dhe as dikton vendsje barre, në kuadër të marrëveshjeve apo instrumenteve ku është palë dhe me të cilat janë të lidhura një apo disa prej aktiveve/pasurive të saj.

## 12. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët.

## 13. Kohëzgjatja

- 13.1 Kjo Marrëveshje është e vlefshme nga data e hyrjes në fuqi deri sa të zgjidhet apo të përfundojë sipas dispozitave të këtij nenit.
- 13.2 Nëse ndodh një nga ngjarjet e mëposhtme që imponon zgjidhjen e marrëveshjes ("Rast i mospërmbushjes"), secila Palë ka të drejtë zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje:
- (i) Shoqëria shpërbëhet;
  - (ii) njëra palë nuk është aksionare e Shoqërisë;
  - (iii) ndodh një Rast i Mospërmbushjes;
- 13.3 Nëse njëra Palë shkel ndonjë nga detyrimet ose përfaqësimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Pala tjetër i dërgon një njoftim brenda 5 ditëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja, ku i kërkon Palës të ndreqë shkeljen duke përbushur detyrimin siç parashikohet në këtë Marrëveshje brenda 30 ditëve nga njoftimi. Nëse pala tjetër nuk realizon ndreqjen e shkeljes, kjo do të konsiderohet si rast mos përbushjeje (**"Rast i mos përbushjes"**).
- 13.4 Në çdo kohë, nëse njëra Palë dëshiron ta zgjidhë këtë Marrëveshje duke zbatuar dispozitat e këtij nenit, ajo Palë u drejton palëve të tjera një njoftim, (këtu e tutje referuar si "Njoftim për Zgjidhje" ku deklaron ngjarjen/rastin mbi të cilin bazohet Njoftimi i Zgjidhjes. Njoftimi i Zgjidhjes bëhet me shkrim dhe i drejtohet Palës tjetër dhe Shoqërisë.
- 13.5 Secila Palë mban përgjegjësi për çdo shkelje të detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje dhe kompenson Palën tjetër për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e shkeljes së këtyre detyrimeve.
- 13.6 Pavarësisht zgjidhjes së Marrëveshjes, Palët nuk çlironë nga detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë ndaj njëra-tjetrës dhe Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj Marrëveshjeje.



## **14. Dispozita e Moskonkurrimit**

- 14.1 Secila Palë e kësaj Marrëveshjeje zotohet së nuk do të ndërmarrë drejtpërdrejt apo tërthorazi ndonjë aktivitet brenda territorit të Shqipërisë dhe Kosovës që konkurron drejtpërdrejtë me aktivitetin e Shoqërisë apo që mund të ketë efekt të ngjashëm.

## **15. Delegimi**

- 15.1 Kjo Marrëveshje është personale për Palët e saj dhe nuk mund t'i delegohet ndonjë pale tjetër pa pëlgimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, përveç rasteve të përcaktuara në një dispozite specifike të kësaj Marrëveshjeje.

## **16. Garanci të Tjera Shtesë**

- 16.1 Secila Palë (me kostot e veta) kryen ose organizon punën për zbatimin e të gjitha veprimeve dhe hartimin e dokumenteve të nevojshme për përbushjen e kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

## **17. Kostot dhe Shpenzimet**

- 17.1 KOSTT do të njohë të gjitha kostot dhe shpenzimet e kryera nga OST, për Procedurat Konkuruese të Përgjedhjes së Pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut, të zhvilluara nga Komisioni i Posacëm, në përputhje me Ligjin nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM nr. 322 datë 15.05.2019 dhe VKM nr. 609 datë 11.09.2019, përfshirë botimin në gazetat kombëtare dhe ndërkombëtare, hartimin e dokumenteve standarde dhe për themelimin e shoqërisë si dhe pranon t'i përballojë ato në përpjesëtim me aksionet e KOSTT në kapitalin e Shoqërisë ALPEX.
- 17.2 Vlera totale e shpenzimeve te kryera nga OST sh.a. sipas parashikimeve të pikës 17.1 është 85,587.53 euro. OST-se i takon të përballojë 57,25% e vlerës totale te shpenzimeve pra 48,998.86 euro. Nga KOSTT do të paguhet 42.75 % e vlerës totale të shpenzimeve pra 36,588.67 euro. Meqenëse totali i shpenzimeve është paguar paraprakisht nga OST, KOSTT merr angazhimin të transferojnë ne llogarinë e OST brenda gjashtë muajsh nga data e regjistrimit shumen prej 36,588.67 euro.
- 17.3 Secila Palë përballon shpenzimet e saj ligjore, kontabël dhe profesionale lidhur me ecurinë, negocimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo marrëveshjeje tjetër formale lidhur me këtë sipërmarrje.

## **18. Njoftimet**

- 18.1 Të gjitha njoftimet e nevojshme lidhur me këtë Marrëveshje apo me ndonjë procedurë arbitrazhi në kuadër të kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim dhe dërgohen në adresën e marrësit e cila përcaktohet në këtë Marrëveshje apo në një adresë tjeter që marrësi e përcakton me njoftim sipas dispozitave të këtij neni.
- 18.2 Çdo njoftim dhe korrespondencë ndërmjet Palëve dërgohen në adresat si vijon.

- a) Nëse i dërgohet OST sh.a:

Në vëmendje të.: Administratorit të OST sh.a.

Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës, Km 9 , Yrshek, Kashar, Tiranë, Shqipëri

Email: info@ost.al

- b) Nëse i dërgohet një aksionari (ëve) tjeter:

Në vëmendje të.:Kryeshefit Ekzekutiv, KOSTT

Adresa: Rruga “Isa Boletini” nr.39, 10000, Prishtinë, Kosovë

Email: info@kostt.com

## **19. Marrëveshja e Plotë**

- 19.1 Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve deri më sot, duke përfshirë çdo Shtojcë të bashkangjitur këtu. Të gjitha Palët pranojnë së nuk janë mbështetur ose nuk janë detyruar të hyjnë në këtë Marrëveshje nga një përfaqësim tjeter përveç çdo përcaktimi të shprehur në këtë Marrëveshje.
- 19.2 Çdo ndryshim, modifikim ose plotësim i kësaj Marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet dhe autorizohet siç duhet nga të gjitha Palët.

## **20. Pavlefshmëria e Pjesshme**

- 20.1 Pavarësisht së ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje mund të provohet së është e paligjshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe me efekt të plotë.
- 20.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të deklarohet ose bëhet e pavlefshme ose do të mbahet e pavlefshme ose e pazbatueshme, një dispozitë e tillë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, sipas rastit, do të zëvendësohet menjëherë me një dispozitë tjeter për të cilën do të bihet dakord nga Palët, të vlefshme në formë dhe substancë dhe të cilat në mënyrë të saktë juridikisht do të përmbushin sa më shumë të jetë e mundur qëllimin dhe synimin e dispozitës së pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme në lidhje me interesat e Palëve.

## **21. Heqja dorë nga të drejtat**

- 21.1 Asnjë heqje dorë e një Pale nga dështimi i ndonjë Pale tjetër për të zbatuar ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si një heqje dorë në lidhje me ndonjë dështim tjetër ose të mëtejshëm qoftë i një karakteri të ngashëm ose të ndryshëm.

## **22. Ligji, Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 22.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjisacionit Shqiptar, me përjashtim të çdo reference të dispozitave të ligjeve në konflikt.
- 22.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga kjo Marrëveshje, janë nën juridikcionin e, dhe do të paraqiten në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

## **23. Kopjet**

- 23.1 Kjo Marrëveshje është bërë në 6 (gjashtë) kopje, secila prej të cilave kur nënshkruhet do të jetë një kopje origjinale, por të gjithë kopjet së bashku do të përbëjnë një dhe të vetmin dokument.

Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje në datë 05 Tetor 2020.

Për Aksionarin OST SH.A.



Për Aksionarin KOSTT SH.A.

KRYESHEFI EKZEKUTIV

